

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	06 / 011 / 2023		
Nj. Org.	Numër	Shifra	Vlera
04-	080104	1510	



Republika e Kosovës/Republic of Kosovo  
Komuna Drenas / Municipality Drenas  
Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural /  
Department of Agriculture , Forestry and Rural Development



## PLAN PROGRAMI I PUNËS - DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (2023)

### Vizioni:

Vizioni ynë është puna e sinqertë dhe e përgjegjshme duke përdorur aftësitë profesionale dhe shkencore në mënyrë që të zhvillojmë sektorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

### Misioni:

Misioni i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) ka për objektive udhëheqjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konkurrues, të fokusuar në trajnimin dhe mbështetjen e fermerëve në Komunën e Drenasit.

### Anita Avdullahu

Drejtore për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Komuna Drenas

Tel: +383 (0) 38/200-40-810

Mob: +383 (0) 49-978-777

E-mail: [anita.a.avdullahu@rks-gov.net](mailto:anita.a.avdullahu@rks-gov.net)

Drenas, Dhjetor 2022

## Synimet Strategjike

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësive të saja në funksion të zbatimit të drejtpërdrejt të ligjeve:

- ✓ Ligjin për tokën bujqësore Nr.02/L-26 ;
- ✓ Ligjin për mbrojtjen e bimëve Nr.02/L-95 ;
- ✓ Ligji për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural – Nr.04/L-074 ;
- ✓ Ligjin për Gjuetinë Nr.02/L-53 ;
- ✓ Ligjin për Bletarin Nr.02/L-111 ;
- ✓ Ligjin për kujdesje ndaj kafshëve Nr.02/L-10 ;
- ✓ Ligji për veterinarinë Nr.2004/21;
- ✓ Ligjin për pyjet e Kosovës Nr.2003/3 ;
- ✓ Ligjin 03/L-153 Për ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit Nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës .

**Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), ka këto detyra dhe përgjegjësi.**

1. Implementon politikat zhvillimore në sektoret e Bujqësisë.
2. Përgatit planet për mbjelljet pranverore , vjeshtore dhe fushaten për korrje-shirje.
3. Organizon trajnime dhe këshillime për fermerët.
4. Jep pëlqim për rikultivimin e tokave Bujqësore.
5. Mban evidencen për tokat Bujqësore .
6. Bashkëpunim dhe përkrahjen e aktiviteteve rreth ujitjes në Kompaninë e “Iber Lepencit” .
7. Bënë mbrojtjen e resurseve natyrore duke përfshirë pyjet, reren (zhavorin) dhe aktivitetet tjera rreth gurëthyesve.
8. Koordinon punët dhe bashkëvepron me OJQ-të që përkrahin aktivitetet-projektet Bujqësore.
9. Bashkëpunon me agjencionet qeveritare për zhvillimin e rajoneve rurale.
10. Planifikon zhvillimin dhe kujdesin permanent të shfrytëzimit të tokës Bujqësore për nevojat dhe intereset e Komunës.
11. Bashkëpunimi dhe koordinimi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
12. Mbrojtja e Pyjeve, Pyllëzimi dhe Ripyllëzimi.
13. Planifikimi i Zhvillimit Rural.
14. Hulumton resurset natyrore duke përfshirë edhe mbrojtjen e shtazëve dhe bimëve.

## PLAN PROGRAMI I PUNËS NË PIKA TË SHKURTA

*DBPZHR ka këto Aktivitete të punës (Janar- Dhjetor 2022)*

1. Planifikimi dhe realizimi i projekteve për vitin 2023;
2. Përgaditja e raporteve javore, mujore, gjashtëmujore dhe vjetore;
3. Regjistrimi i fermerëve të rinj në regjistrin e fermës, lëshuarja e Çertifikatës së regjistrit të fermës (Nif) dhe të informative përcjellëse të fermës (Anexi) ;
4. Organizimi i trajnimeve për fermerë në të gjithë sektoret e bujqësisë;
5. Përcjellja e punëve tjera të drejtorisë - shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave 2023 ;
6. Pranimi i faturave për shpenzimet e bëra për nevojat e Drejtoratit si dhe raportimi i tyre;
7. Pjesmarrje në komisione të ndryshme;
8. Ofrimi i shërbimeve kshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural , që të lehtësoj dhe ndihmoj më tej vet iniciativat e fermerëve dhe komuniteteve rurale;
9. Dhënia e këshillave në të gjithë sektoret e bujqësisë: pemëtari, perimtari, blegtori, bletari, shpeztari ( krasitja, mbrojtja nga sëmundjet e ndryshme, rritja e cilësisë dhe sasisë së qumështit etj.)
10. Dhënia e informacioneve rreth grandeve për mbështetjen e fermerëve nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);
11. Perkraja e fermereve me projekte nga DBPZHR në sektorë të ndryshëm ;
12. Pranimi i aplikacioneve dhe digjitalizimi i parcelave të fermerët për subvencionimin e grurit, misërit , pemëve , perimeve, bimëve mjekuese aromatike etj. dhe pranimi i aplikacioneve për sektorin e blegtorisë dhe bletarisë në kuadër të subvencionimit për pagesa direkte , si dhe dorzimi i lëndëve në MBPZHR;
13. Monitorimi i të mbjellurave pranverore në territorin e komunës së Drenasit;
14. Vizita në terren për identifikimin e fermerëve për investime në planifikim projekte të prodhimitarisë bujqësore në bashkpunim me OJQ-të ;
15. Projekti për vakcionimin e qenëve shtëpiak;

16. Monitorimi i projektit të vakcionimit të qenëve shtëpiak
17. Planifikimi dhe realizimi i mbjelljeve pranverore në Komunën e Drenasit;
18. Raportimi në MBPZHR për planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve pranverore;
19. Planifikimi i fushatës së korrje-shirjeve;
20. Bashkëpunim me pronaret e mullinjeve dhe pikat grumbulluese lidhur me përgatitjen për grumbullimin e sasisë së grurit nga fermëret;
21. Formimi i komisionit për kontrollimin e autokombanjave para fillimit të korrje- shirjeve;
22. Monitorimin e mullinjeve dhe pikave grumbulluese të Komunës lidhur me përgatitjet për grumbullimin e sasisë së grurit nga fermerët;
23. Monitorimi dhe përcjellja e korrje-shirjeve gjatë realizimit- kontrollimi i autokombanjave dhe cilësisë/sasisë së grurit;
24. Raportimi në MBPZHR për realizimin e korrje-shirjeve dhe nxjerrja e rendimentit mesatar për drithërat e bardha 2023;
25. Takime me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural rreth kordinimit te projekteve (MBPZHR);
26. Takime me MBPZHR, si dhe OJQ-të e ndryshme rrethe bashkpunimit për projekte;
27. Organizimi i takimeve me fermerët për çeshtjen e grumbullimit të qumështit, vizita në pikat grumbulluese ;
28. Vizitë tek fermat blegtorale, shpeztari, si dhe të fermeret pemëtar, perimtar, bletar etj;
29. Bashkëpunim me veterinarët e licencuar për komunën e Drenasit rreth matkulimit dhe vakcionimit të kafshëve shtëpiake!
30. Planifikimi dhe realizimi për mbjelljet vjeshtore në Komunën e Drenasit ;
31. Monitorimi i të mbjellurave Vjeshtore në territorin e komunës së Drenasit;
32. Raportimi në MBPZHR për planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve vjeshtore, ;
33. Dhënja e këshillave ( trajnime )për vedisimin e qytetarve për mos ndertimin e objekteve ne tokat bujqësore e mos degradimit e tokave bujqësore nga ndertimet e reja.
34. Krijimi i një sistemi sektorial bujqësore intenziv dhe të qëndrueshem duke u orjentuar ne terheqjen e investimeve të mundshëme ne bujqësi – nga Qeveria, BE , OJQ etj.

35. Ngritja dhe avancimi i sistemit të menaxhimit të tokës për prodhimin e kulturave të ndryshme bujqesore me synim të krijimit të një identiteti të njohur prodhues.

36. Analizimi mbi të arriturat e vitit 2023 në bujqësi;

Nr	Qëllimi	Aktiviteti	Stafi përgjegjës	Afati
1	Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve dhe tokave pyjore	Kontrollimi i terreneve ekonomiko – pyjore dhe tokave pronë e pylltarisë , intervenimi ne ato vende nese ka uzurpime të tokave pyjore të pylltarisë me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre	Shefi , tekniku dhe pylltarët	Punë permanente për gjatë gjithë vitit
2	Dërgimi i fletparaqitjeve në Prokureri dhe Gjykatë	Përgaditja e kallximeve penale për dërgim ne Prokurin e shtetit dhe lëndet kundervajtse ne gjykate	Shefi i sektorit	Punë permanente
3	Trajtimi i terreneve ekonomiko-pyjore	Gjatë trajtimit bëhet pastrami i degeve të haloreve dhe mbeturinat	Stafi I sektorit të pylltarisë	Mars, Prill, Shtor Tetor dhe Nentor
4	Inspektimi ne tregje të druve ku kontrollohen fletperciellja dhe stivosja e druve	Në bashkëpunim me inspektoriatin qendror të pyjeve, inspektorin komunal dhe policin behet konfiskimi i mases drunore leshohet fletkonfiskimi dhe ngriten procedurat kundervajtse	Shefi i sektorit , Policia , Inspeksioni dhe tekniku i pylltarisë.	Gjatë gjithë vitit
5	Kërkesa për kompenzimin e dëmit	Përmbarimi i lëndve në gjykatë dhe pagesa nga autoriteti pyjor komunal	Shefi I sektorit	Gjatë gjithë vitit
6	Pranimi i kërkesave për pyjet private	Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për pyjet private bëhet nga drejtoria kordinuse ne Prishtine	Shefi dhe tekniku i pylltarisë	Janar–Mars
7	Bashkëpunimi me organet e komunës	Bashkëpunimi me Policinë , zjarrëfikesit Inspektorët etj,	Shefi i sektorit të pylltarisë dhe organet e komunës.	Punë permanente
8	Ruajtja e pyjeve nga zjarret	Bashkëpunimi me zjarrëfiksit me qëllim të shuarjes së zjarreve nëse ato ndodhin.	Shefi i pylltarisë , pylltarët,zjarrëfiksit	Qershor-tetor
9	Kontrollimi i terreneve pyjore	Dalja në ndihmë pylltarëve	Shefi i sektorit të pylltarisë	Punë permanente

10	Kontrollimi i ditareve të punës	Kontrollimi i ditareve të punës të gjithë pylltarëve	Shefi i sektorit	Gjatë gjithë vitit
11	Bashkëpunimi me agjensionin e pyjeve në Kosovës, drejtorin kordinuse ne Prishtinë	Përgaditja e raporteve mujore dhe dërgimi i të njejtave ne DK – Prishtinë .	Shefi i sektorit	Gjatë gjithë vitit
12	Regjistrimi i të gjitha terreneve ekonomiko pyjore për vitin 2023	Formimi i komisioneve , dalja ne teren dhe regjistrimi i dëmeve pyjore	Tekniku dhe të gjithë pylltarët	Shtator-Nëntor
13	Pyllëzimi	Pyllëzimi i sipërfaqeve të reja	Shefi,tekniki i pylltarisë	Tetor-Nëntor
14	Parandalimi i gjuetisë ilegale	Parandalimi i gjuetisë ilegale dhe përkujdesja për mbrojtjen e kafshëve të egra.	Stafi teknik dhe Roja e Pyllit	Punë permanente